

# AKT - THEMELIMI

I



## SHOQËRISË TREGTARE "M.Z. FASHION" SH.P.K.

Në bazë të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" dhe atij nr.7667, datë 28.01.1993 "Për regjistrin tregtar", me vullnetin e tyre të lirë z.Samir Mane, i biri i Fatmirit, i datëlindjes 24 Dhjetor 1967, i lindur në Korçë e banues në Tiranë dhe z.Zoran Antic, i lindur dhe banues në Kumanovë, Maqedoni, të dy madhorë e me zotësi të plotë juridike për të vepruar shpallin si vijon :

### NENI 1

Formohet shoqëria tregtare e emërtuar "**M.Z. FASHION**" SH.P.K.

(shoqëri me përgjegjësi të kufizuar) me themelues z.Samir Mane dhe z.Zoran Antic.

### NENI 2

Shoqëria do të këtë statusin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe do të përballojë humbje deri në kufirin e kontributit të themeluesit të saj në kapitalin themeltar.

### NENI 3

Shoqëria e ka selinë e saj në Rt. "Jordan Misja" ish UMB, Tiranë. Ajo mund të çelë dhe seli të tjera të dyta, degë e filiale, përfaqësi dhe agjensi operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe me miratim të organeve kompetente edhe jashtë vendit.

### NENI 4

Shoqëria do të ketë kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj me një afat të pacaktuar mbi 10 vjet.

### NENI 5

Objekti i veprimtarisë së saj do të jetë :

- tregtim të artikujve të ndryshëm, Import-Eksport, pajisje elektrike e elektronike, elektroshtëpiake, ushqimore, bujqësore e blegtorale, deteritive, veshmbathje, industriale, lëndë të para për industrinë, materiale ndërtimi e hidrosanitare, pajisje zyrash dhe kancelari, pjesë këmbimi auto e makineri të çdo lloji, pajisje

teknologjike, karburante, vajra lubrifikantë etj., si dhe tregtimi i tyre me shumicë e pakicë brenda e jashtë vendit.

- servis pajisjesh elektronike dhe elektroshtëpiakë, automjetesh, etj.
- transport të mallrave e të udhëtarëve urban, ndërturban dhë ndërkontrollor.

#### **NENI 6**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lekë i përbërë nga kontributi i ortakëve z.Samir Mane 51% dhe z.Zoran Antic 49%. Kapitali themelues mund të ndryshojë sipas vendimit që mund të marrin ortakët, por asnjëherë nuk mund të pakësohet nën nivelin e kapitalit themeltar. Kapitali është tërësisht i shlyeshëm e i nënshkrueshëm.

#### **NENI 7**

**Shoqëria ka vulën e saj me përbajtje “M.Z. FASHION” SH.P.K. .**

#### **NENI 8**

Organet drejtuese të shoqërisë do të janë:

- Asambleja e Ortakëve
- Administratori

Fusha e veprimit, përbërja dhë mënyra e funksionimit të organeve drejtuese rregullohet në statut.

#### **NENI 9**

Administratorët e shoqërisë “M.Z. FASHION” SH.P.K. janë z.Samir Mane, i biri i Fatmirit, i datëlindjes 24 Dhjetor 1967, banues në Tiranë dhe z. Zoran Antic lindur dhe banues në Kumanovë, Maqedoni.

#### **NENI 10**

Shoqëria konsiderohet e krijuar në përputhje me nenet e këtij akt – themelimi e të statutit bashkëlidhur aktit.

#### **NENI 11**

Ky akt përpilohet në disa kopje për t'ju shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje mbetet në dokumentacionin e shoqërisë.


### **ORTAKËT E SHOQËRISË TREGTARE “M.Z. FASHION” SH.P.K.**

**SAMIR MANE**



2

**ZORAN ANTIC**



# STATUT

## I

### SHOQËRISË TREGTARE "M.Z. FASHION" SH.P.K.

Në bazë të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" dhe atij nr.7667, datë 28.01.1993 "Për regjistrin tregtar", me vullnetin e tyre të lirë z.Samir Mane, i biri i Fatmirit, i datëlindjes 24 Dhjetor 1967, i lindur në Korçë e banues në Tiranë dhe z.Zoran Antic, i lindur dhe banues në Kumanovë, Maqedoni, të dy madhorë e me zotësi të plotë juridike për të vepruar shpallin si vijon :

#### NENI 1

Formohet shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar e emërtuar "**M.Z. FASHION**" SH.P.K. me themelues Ortakët z.Samir Mane dhe z.Zoran Antic.

#### NENI 2

Shoqëria do të ketë statusin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe do të përballojë humbje deri në kufirin e kontributit të themeluesit të saj në kapitalin themeltar.

#### NENI 3

Shoqëria e ka selinë e saj në Rt. "Jordan Misja" ish UMB, Tiranë. Ajo mund të çelë dhe seli të tjera të dyta, degë e filiale, përfaqësi dhe agjensi operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe me miratim të organeve kompetente edhe jashtë vendit.

#### NENI 4

Shoqëria do të ketë kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj me një afat të pacaktuar mbi 10 vjet.



## NENI 5

Objekti i veprimitarisë së saj do të jetë :

- tregtim të artikujve të ndryshëm, Import-Eksport, pajisje elektrike e elektronike, elektroshtëpiake, ushqimore, bujqësore e blegtorale, deteritive, veshmbathje, industriale, lëndë të para për industrinë, materiale ndërtimi e hidro-sanitare, pajisje zyrash dhe kancelari, pjesë këmbimi auto e makineri të çdo lloji, pajisje teknologjike, karburantë, vajra lubritifikantë etj., si dhe tregtimi i tyre me shumicë e pakicë brenda e jashtë vendit.

servis pajisjesh elektronike dhe elektroshtëpiake, automjetesh, etj.

transport të mallrave e të udhëtarëve urban, ndërurban dhe ndërkombëtar.

## NENI 6

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lekë i përbërë nga kontributi i Ortakëve z.Samir Mane 51% dhë z.Zoran Antic 49%. Kapitali themeltar mund të ndryshojë sipas vendimit që mund të marrë ky ortak, por asnjëherë nuk mund të pakësohet nën nivelin e kapitalit themeltar. Kapitali është tërësisht i shlyeshëm e i nënshkrueshëm.

## NENI 7

Kapitali i shoqërisë do të përbëhet nga kapitali themeltar, mjetet e xhiros dhe të tjera të nevojshme të luajtshme apo të paluajtshme për ushtrimin e aktivitetit të shoqërisë.

## NENI 8

Aktiviteti dhe rezultati i tij konkretizohen në nxjerrjen e bilanceve periodikë e vjetorë.

## NENI 9

Shoqëria është përdoruese dhe disponuese e pasurisë së saj. Ajo mund të blejë dhe mund të shfrytëzojë të drejta materiale ose jo materiale, duke përfshirë edhe të drejtën e shitjes së pasurisë së saj tek të tretët. Në Republikën e Shqipërisë kjo shoqëri gëzon të drejta si çdo person tjetër juridik shqiptar ose i huaj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

## NENI 10

Shoqëria vepron në regjistrin e pronës dhe mund të marrë përsipër të drejta dhe detyrime vetëm brenda kapitalit të saj. Ortakët mbartin treziku e veprimitarisë së shoqërisë vetëm në nivelin e kapitalit të investuar në të.

## NENI 11

Organet drejtuese të shoqërisë do të janë :

- Asambleja e Ortakëve

- Administratori

Fusha e veprimit, përbërja dhe mënyra e funksionimit të organeve drejtuese rregullohet si më poshtë.

### NENI 12

Asambleja e Ortakëve si organi më i lartë drejtues i shoqërisë tregtare “M.Z.

**FASHION” SH.P.K** ka këto kompetenca:

- të emërojnë e shkarkojnë administratorin ose administratorët e shoqërisë
- të marrin vendime për rrithjen dhe zvogëlimin e kapitalit
- të marrin vendime për ndryshime në statut
- të miratojnë bilancet vjetore dhe strategjinë e veprimtarisë së shoqërisë
- të marrin vendime për shitje të kuotave të kapitalit si dhe të transferimit të pjesshëm apo të plotë të tyre
- të marrin vendime për prishjen dhe likuidimin e shoqërisë.

Asambleja mblidhet një herë në vit dhe Ortakët lajmërohen të paktën 15 ditë përpara me letër rekomande ku përcaktohet edhe rendi i ditës. Lajmërimi bëhet nga administratori ose nga personi i ngarkuar prej tij. Vendimet që merren në mbledhjen e Asamblesë duhet të kenë miratimin e një ose disa ortakëve që përfaqësojnë më shumë se gjysmën ( 51% ) e kapitalit filletar

### NENI 13

Administratorë të shoqërisë “M.Z. FASHION” SH.P.K. janë z.Samir Mane dhe z.Zoran Antic, të dy madhorë dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

### NENI 14

Me vendim të Asamblesë së Ortakëve administratori dhe personi i ngarkuar prej tyre janë të veshur me të gjithë fuqinë për detyrimin e zakonshëm e të jashtëzakonshëm të shoqërisë pa asnjë kufizim. Ata kanë mundësinë për të kryer të gjithë aktet që konsiderojnë të përshtatshme për arritjen e qëllimeve të shoqërisë. Ata kanë të drejtë, midis të tjerave, të blejnë e të këmbejnë pasuritë që lidhen me shoqëri të tjera brenda dhe jashtë vendit duke siguruar pjesëmarrijen për qëlliimet e veprimtarisë parashikuar nga neni 5 i këtij statuti. Ata kryejnë çdo lloj veprimi pranë të gjithë zyrave shtetërore e private që kanë të bëjnë me garancitë dhe veprime hipotekore, të kryejnë pranë institucioneve bankare e financiare veprime depozitimi, kreditimi, pagesa dhe arkëtime si dhe veprime të tjera që i shërbejnë aktivitetit. Në këto raste personi i ngarkuar nga administratori është i detyruar të njoftojë e t'i japë llogari atij.

## **NENI 15**

Administratori, sipas nevojave që paraqiten për zhvillimin e veprimitarisë së shoqërisë, punëson persona të cilëve u cakton detyrat dhe pagën. Shoqëria merr përsipër të respektojë rregullat e punësimit në Republikën e Shqipërisë dhe sigurohet.

## **NENI 16**

Marrëdhëniet e punës në këtë shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratës së punës. Për çështjet që nuk parashikohen në to zbatohen dispozitat e Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë. Mosmarrëveshjet e punonjësve me shoqerinë do të zgjidhen në Gjykatën Shqiptare. Punonjësit e emëruar nuk marrin pjesë në ndarjen e fitimit të realizuar nga shoqëria gjatë aktivitetit të saj, nëse në kontratën e punës nuk është parashikuar ndryshe. Për punën e kryer punonjësit marrin pagë siç është parashikuar në kontratë.

## **NENI 17**

Veprimet ekonomiko-financiare të shoqërisë nisin vitin e parë në momentin e regjistrimit në organet tatimore, ndërsa vitet e tjera në Janar dhe mbyllen në 31 Dhjetor të çdo viti. Në fund të çdo periudhë ushtrimore hartoherë bilanci kontabël sipas ligjeve në fuqi. Bilancet periodikë miratohen e nënshkruhen nga Administratori, ndërsa ai vjetor miratohet nga Asambleja e Ortakëve. Me miratimin e tyre Ortakët vendosin për krijimin e fondeve rezervë të akumulimit, etj.

## **NENI 18**

Të ardhurat në to pas veçimit të fondeve të sipërpërmendura dhe shlyerjes së detyrimit fiskal i mbesin në përdorim Ottakëve të shoqërisë. Konvertimi i parasë së realizuar do të bëhet sipas kushteve të bankës kombëtare ose bankave të tjera të nivelit të dytë, ndërsa transferimi i tyre do të bëhet sipas ligjeve shqiptare.

## **NENI 19**

Shoqëria ka vulen e saj me përbajtje **“M.Z. FASHION” SH.P.K.**

## **NENI 20**

Shoqëria konsiderohet e krijuar në përputhje me nenet e këtij statutit dhe aktit të themelit bashkëlidhur dhe fiton personalitetin juridik me regjistrimin ne Gjykatën e Rrethit Tiranë.

## **NENI 21**

Shoqëria mund të prishet në çdo kohë me vendim të Asamblesë. Në këtë rast Asambleja cakton një ose më shumë Likujdatorë. Likujdatori dhe Administratori

janë përgjegjës për ruajtjen e pasurisë për derisa t'ju dorëzohen personave përkates duke likujduar në radhë të parë detyrimet fiskale e detyrimet ndaj të tretëve.

### NENI 22

Për sa nuk është shprehur në këtë statut i referohet plotësimet që do të bëjnë Ortakët si dhe ligjeve të veçanta në të cilat është referuar hartimi i këtij statuti.

### NENI 23

Ky statut përpilohet në disa kopje për t'ju shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje mbetet në dokumentacionin e shoqërisë.

## ORTAKËT E SHOQËRISË TREGTARE “M.Z. FASHION” SH.P.K.

SAMIR MANE

SAMIR MANE



ZORAN ANTIC

ZORAN ANTIC

